



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

HISTORIKU DHE MISIONI I UMT-së

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë u themelua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.1.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)” i ndryshuar.

Me krijim e Universitetit të UMT-së, pjesë e tij u bën fakultetet, të cilët u shkëputën nga struktura shumë vjeçare e Universitetit të Tiranës dhe u bënë pjesë përbërëse e pesë njësive kryesore të këtij universiteti, fillimisht në pesë Fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Shëndetit Publik dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.

Në kuadër të riorganizimit të universitetit, aktualisht Universiteti i Mjekësisë, Tiranë aktualisht përbëhet nga 3 (tri) njësi kryesore (fakultete), konkretisht:

1. Fakulteti i Mjekësisë;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ofron një imazh të ri dhe vjen si një plotësim i kërkesës së domosdoshme të mjekësisë shqiptare, për një menaxhim më të mirë të mësimdhënies dhe centralizim të studimeve mjekësore në një njësi të vetme dhe plotësuese. Ky universitet publik mundëson kombinimin e studimeve teorike dhe atyre shkencore nga profesorët e nderuar me provojë shumëvjeçare, me aftësitë konkrete për t’i zbatuar në praktikë ato pranë Qendrave Spitalore Universitare të vendit.

FUNKSIONET DHE DETYRAT E UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme, kërkimin shkencor dhe veprimtaritë mbështetëse në fushën e shkencave të mjekësisë.

Sa më sipër detyrat dhe funksionet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë janë:

1. Të sigurojë zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë;

2. Formimin universitar të studentëve dhe specialistëve në të tria ciklet e studimeve në shkencat mjekësore;
3. Kualifikimin e specialistëve në fushën mjekësore;
4. Thellimin e kualifikimit të punonjësve akademikë dhe shkencorë universitarë;
5. Kryerjen e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar në shkencat mjekësore;
6. Ofrimin e edukimit në vazhdim të specialistëve në fushën mjekësore;
7. Realizimin e funksioneve mësimore dhe kërkimore-shkencore, diagnostikuese dhe trajtuese në nivel të lartë shkencor, nëpërmjet njësive bazë dhe shërbimeve, ku këto të fundit janë njësi të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor, të cilat realizojnë shërbime terciare, si pjesë e universitetit dhe strukturës së qendrave spitalore universitare;
8. Garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore e shëndetësore, duke siguruar realizimin dhe nxitjen e kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe promovimin e të rejave në fushën e shkencave mjekësore;
9. UMT-ja, në bashkëpunim me studentët, qeverinë, shërbimin shëndetësor dhe shoqërinë civile, transmeton dije dhe përgatit profesionistë të shëndetit, që të praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve, si dhe përparimin e kërkimit shkencor në dobi të shëndetit.